

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.Zh., nga Prishtina, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 3 nën par 3.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2688/2018, të dt.05.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.08.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit F.Zh., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2688/2018, të dt.05.06.2018, **vërtetohet.**

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2688/2018, të dt.05.06.2018, është shpallur fajtor i akuzuari F.Zh., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 3 nën par 3.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzetë) €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej 30 (tridhjetë) €, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzetë e pesë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara E.K. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari F.Zh., duke mos cekur ndonjë nga bazat ankimore, mirëpo nga përmbajtja e ankesës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shpenzimeve të procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, sa i përket kësaj pjese.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.626/2018, të datës 07.08.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit F.Zh., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

## **Ankesa e të akuzuarit F.Zh., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shpenzimeve të procedurës penale, duke theksuar se i njëjti nuk ka mundësi që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale sepse është i gjendjes së varfër ekonomike, dhe jeton vetëm nga ndihma sociale, mirëpo kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka obliguar që paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në kuptim të nenit 450 par 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK, si dhe për vendimin lidhur me kompensimin e viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, andaj, si i tillë aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, kolegji i Gjykatës së Apelit, të njëjtin e ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimin, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, se është baba i tre fëmijëve, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj, në prani të këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitën ligjore nga neni 74 të KPK, përkitazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese sikurse pretendon i akuzuari në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.820/2018, të datës 29.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**